REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.6572 Prot Maliq, më 02.11.2026

VENDIM
Nr. 123 datë 30.10.2026

"Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 30.10.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 3, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 66, pika 11 e Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 30.10.2026 me ndryshimet e propozuara dhe njoftimit bashkangjitur.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.11.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.6173/2 Prot.

Maliq, më 23.10.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e premte **më datë 30 10.2026, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026"; i ndryshuar.
7.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim";
8.Informacion nga grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e ankesës së qytetarit E.Çuçllari.
9.Informacion nga ekzekutivi lidhur me kontratat e HEC-eve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë Maliq.
10.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e mërkurë me datë 28.10.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5 të rendit të ditës:z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari.

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pika 6 e rendit të ditës:z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 7 e rendit të ditës:z.Idlir Limllari, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi, z.Selami Muço.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI